

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ç'na duhet leku i fortë kur nuk ul dot çmimin e naftës?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/na-duhet-leku-i-forte-kur-nuk-ul-dot-cmimin-e-naftes-i586369
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 07:07:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e1b836fbaa4299912b9389ac69693a272455ce3841345328fbccdd4bbd968a548
TEKSTI	e4745f6c1a128ed171f0dca7ad62c9bad8e9a455e5f3fd100935ea5f8816f9ac
PAMJA	d465bb951c567352d5cad908340e8d925ee9125655d2c41b5b6f4f7f261788c7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	754f6bb7ac9accdee91c47887bff77cdb15f5b326655abc132c1a47ea9d4df7d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/754f6bb7ac9accdee91c47887bff77cdb15f5b326655abc132c1a47ea9d4df7d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Moyo Beach ne ritmin e veres: Muzike, det dhe nje eksperience interaktive](#) Diskutohet e drejta e autorit ne Komisionin per Kulturen Kim Kardashian merr vetem 1 euro de fundit

Ç'na duhet leku i fortë kur nuk ul dot çmimin e naftës?



16 Shtator 2026, 09:01 Blog TEMA



Nga Rildo Ngjela

Leku rritet.

Bashkë me të edhe nafta.

Euro dhe Dollari kapën rekorde të reja, sigurisht zbritëse.

E rënësishme është që Leku po kap majat.

Patjetër që çmimet në rritje të naftës në bursat ndërkombëtare e shpjegojnë këtë rezultat, por llogaritja se si del çmimi në tabela mbetet enigmë.

FAKT: Më 19 qershor, kur Bordi i Transparencës ndaloi veprimtarinë, nafta kushtonte 176 lekë dhe benzina 166. Në më pak se tre muaj të dyja u rritën me 53 lekë ose 30% më shumë.

Aktualisht po përballemi me çmim të ri pa një tavan apo përllogaritje zyrtare që veçon kuotimet ndërkombëtare, kurset e këmbimit, taksat, kostot e importit dhe marzhet e kompanive.

Na u premtua se sa herë që çmimi do të arrijte në 200 lekë për litër do të ndërhynte Bordi. Me 22 korrik çmimi shkoi 206 lekë për litër. Pastaj u ul në 199 deri në 5 gusht dhe u rrit në 215 lekë me 14 gusht. Kjo rritje vazhdoi deri sot kur kemi arritur në 229 lekë për litër. Për 33 ditë radhazi çmimi i naftës ka qëndruar mbi 200 lekë për litër. Këto 33 ditë pa ndërprerje kërkojnë një përgjigje.

Heshtje!

Meqë nga Bordi nuk ka asnjë sinjal për ringjallje, po Autoriteti i Konkurrencës çfarë po bën? Nuk e di nëse e kanë vënë rë edhe ata që rrjetet më të mëdha të shitjes së karburantit me pakicë, kanë fiksuar çmimin në 229 lekë për litër. Mendoj se ky është një sinjal që kërkon shqyrtim të faturave të importit, datat e dërgesave, inventarët, kontratat dhe marzhet e kompanive gjatë kohës së ndryshimit të çmimeve. Çdo qytetar do të u ishte mirënjohës nëse Autoriteti do të niste një hetim për këtë punë. Ose të paktën një kontroll që lidhet me koordinimin e e çmimeve mes kompanive. Në mars njoftoi se po mbante nën monitorim kompanitë e karburantit dhe kaq. Gjashtë muaj më vonë nuk kemi asnjë raport apo përfundim. Asnjë komunikim. Deri tani po paraqiten si një spektator i paiteresuar që përfaqësohen vetëm me zyra dhe godina.

Kaq sa i përket mekanizmave institucionalë.

Një organ tjetër që mund t'i qajë hallin qytetarëve është opozita. Opozita ka folur. Më 3 prill. Që atëherë ky problem është përmendur si një problem periferik mes rreshtash deklaratash dhe nëpër dhembë gjatë debeteve televizive, që përsëriste të njëjtat propozime që bënë në prill.

Fjasko edhe këtu.

Kjo na kthen tek pyetja që po vazhdon të shmanget se çfarë dobie ka një Lek o fortë nëse përfitimet e tij nuk arrijnë kurrë deri të pompa e naftës?

Eksportuesit marrin më pak lekë për çdo euro të fituar, ndërsa familjet që mbështeten te remitancat marrin më pak lekë për çdo euro të dërguar në vend. Drejtuesit e automjeteve vazhdojnë të paguajnë 229 lekë për litër. Qeveria e kremton kursin e këmbimit si dëshmi të forcës ekonomike, ndërsa askush nuk po e thotë se kush e përfiton avantazhin e krijuar nga ky kurs. Kur ky avantazh përthithet nga taksat, marzhet e pashpjegueshme dhe mosveprimi institucional, leku i fortë shndërrohet në një statistikë zyrtare me pak vlerë për qytetarin. Derisa të publikohet formula e plotë e çmimit dhe Autoriteti i Konkurrencës të japë llogari për gjashtë muaj monitorim të heshtur, çmimi i shfaqur në pompë do të mbetet gjykimi më i qartë i qytetarëve mbi vlerën reale ekonomike të monedhës së fortë të Shqipërisë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

24 orë para verdiktit

16:25 Blog / 17 komente

Terrori që vetëm Pupin mund ta shohë

15:34 Blog

[Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë](#)

15:25 Blog / 21 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.